



A.SH. Engineering sh.p.k.

Cel : 0692080982

E-mail : ashengineer2000@gmail.com

VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS (VNM)

“RINDERTIM SHKOLLA 9-VJECARE SHEZE”



PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Qellimi i VNM

Grupi i inxhinierëve që studiojnë zonën ku kalon projekti për punën e një raporti të përgjithshëm për vlerësimin e ndikimit në mjedis. Qellimi i këtij raporti është pasqyrimi i të gjitha detajeve që lidhen me mjedisin, studimin e terrenit rreth e për qark shkolles (menaxhimi dhe sistemi i sipërfaqeve të gjelbruara të gjeoteknikës, sistemi i burimeve ujore si dhe masat e lehtësimit për rehabilitimin e tyre nga ndotja si pasoje e rikonsuksionit/rehabilitimit të objektit ekzistues.

Ky raport do të shërbejë si instrument për mbrojtjen e mjedisit, reduktim të ndotjes ekzistuese, mbrojtje të pasojave financiare dhe socio-psikologjike.

INFORMACION MBI PROJEKTIN

Godina në fjalë është e vendosur në Shqipëri dhe në një terren fushor me sip. 5275m².

Rindertimi i godinës 1-kt shkolle 9-vjeçare, dhe godina 1-kt kopesht në territorin e Bashkisë Peqin do të shërbejë si institucion arsimor. Në katin përde bëjnë pjesë:

Kuadri Politik, Ligjor dhe Administrativ Politika

Gjatë dhjetë vjeçarit të fundit qeveria ka filluar zhvillimin e një kuadri për të ndryshuar degradimin mjedisor i cili ka ardhur si rezultat i industrializimeve të mëparshme gjatë sundimit komunist, i cili ka anashkaluar mbrojtjen e mjedisit pothuajse plotësisht. Menaxhimi dhe mbrojtja e mjedisit janë pjesë e Legjislacionit i cili kërkon nga Republika e Shqipërisë që:

“Te mirembaje një mjedis të pershtatshëm të shëndetshëm dhe ekologjik për brezat e sotëm dhe të ardhshëm”.

Për më tepër, Legjislacioni kërkon që burimet natyrore të cilat duhet të shfrytëzohen racionalisht në përputhje me principe të bazuara.

Politikat e përpiluara për mjedisin në ditët e sotme janë pasqyruar në ligjin e vitit 2002. Kapitulli II “Politikat Mjedisore” përcakton politiken e qeverisë për:

- ✓ politika shtetërore mjedisore – përcakton pozicionin e mjedisit në legjislacion, vendin

- e strategjive te sektoreve kombetare dhe planet lokale si pjese e politikës mjedisore dhe percakton organizmat te cilet do te administrojne keto politika.
- ✓ programet dhe strategjite mjedisore – percakton Planin e Veprimit Kombetar te Mjedisit (PVKM) i cili duhet te prodhoje cdo dhjete vjet nje raport mjedisor ne zbatimin e PVKM per Keshillin e Ministrave
 - ✓ planet lokale mjedisore – kerkojne nga qeverisja lokale te zhvillojne Planet lokale te Veprimit te Mjedisit (PLVM) duke perdorur organizmat kombetare per te ofruar te dhena dhe mbeshtetje teknike, per qeverite lokale te lidhen me publikun, OJQ dhe biznesin per zhvillimin e planeve dhe Kryetaret e Bashkive te raportojne ne Keshillin e Rretheve per zbatimin e planeve ne fund te cdo viti.

Percaktimet te vecanta ne mbrojtjen e aspekteve mjedisore, jane perfshire ne Kapitullin III “Shfrytezimi dhe Mbrojtja e Perberesve te Mjedisit”. Kjo perfshin nevojat per mbrojtje te njejte te te gjithë burimeve, nevojën per zhvillimin e aktiviteteve (duke perfshire bujqesine dhe menaxhimin e mbetjeve) mosndotjen e tokes, te ajrit ose te ujit, te vendose kritere per te percaktuar se si duhet te shfrytezohen burimet e ujit, ndalimin e importeve ose perdorimit te substancave shkaterruese per ozonin, te mbroje biodiversitetin dhe mjedisin e ndertimeve, kufizimet e zonave per mbeturinat, kontrollin e substancave te rrezikshme dhe vendosjen e tarifave dhe taksave mjedisore.

Qeveria Shqiptare ka publikuar Planin e pare Kombetar te Veprimit te Mjedisit (PKVM) ne vitin 1993, i cili percakton qellimet mjedisore qe synohen per nje plan veprimi per vendin. Struktura e pare Mjedisore eshte ngritur ne vitin 1994 dhe nje strukture e dyte eshte ngritur ne vitin 1998.

Baza Legjislative

Legjislacioni qe drejton mbrojtjen e mjedisit eshte fuqizuar relativisht me shpejtesi ne Shqiperi. Ligji i pare per Mbrojtjen e Mjedisit doli ne vitin 1993 dhe u mendua ne vitin 1998 dhe 2001. Ky ligj percakton ne Kapitullin II (Vleresimi i Ndikimeve te Mjedisit) Neni 7 se:

“te gjithë aktivitetet natyrale dhe te personave legale, vendas ose te huaj, te cilet ushtrojne aktivitetin e tyre ne territorin e Republikës se Shqiperise, do te jene subjekte te vleresimeve te ndikimeve te mjedisit”.

Neni 8 jep ne terma te pergjithshme llojet e aktiviteteve per te cilat autoritetet do te kerkojne Vleresimet e Ndikimeve te Mjedisit (VNM). Neni 9 specifikon pergjegjesine e autoriteteit qe do te jete Komitetit i Mbrojtjes se Mjedisit, dhe aktivitetet e tij rajonale. Ligji nuk specifikon fazat individuale te procesit te VNM.

Me vone doli Ligji Nr.8934 per Mbrojtjen e Mjedisit. Ky shfuqizoi te gjithë ligjet e meparshme per mbrojtjen e mjedisit dhe ka ne princip dhjete fusha kryesore te drejtimit:

- Politikat Mjedisore
- Shfrytezimi dhe Mbrojtja e Perberesve te
-

Mjedisit Vleresimi i Ndikimeve te Mjedisit

- Lejet per Aktivitetet te cilat ndikojne ne
- Mjedis Ndalimi dhe Kufizimi i Ndotjes se
- Mjedisit Monitorimin dhe te Dhenat
- Kontrollin Mjedisor
- Detyrat e Organizmave Shteterore per
- Mjedisin Rolin e Publikut
- Sanksionet

Ligji Nr. 8934 per Mbrojtjen e Mjedisit i dates 5/09/2002 percakton se mbrojtja e mjedisit eshte e detyrueshme per te gjithë personat, juridike dhe individuale te cilat ushtrojne aktivitet ne Shqiperi. Neni 34 kerkon nga cdo person ose organizate te marrin lejen nga organizmat pergjegjes (Ministria e Mjedisit) ne menyre qe te zhvilloj cdo pune te vecante ne Shqiperi e cila ndikon ne mjedis. Qe te merret kjo leje duhet te pergatitet nje vleresim per ndikimet e mjedisit.

Deri ne kohet e fundit nuk ka pasur procese legale te percaktuara per zhvillimin e VNM. Nje ligj per Vleresimet e Ndikimeve te Mjedisit u pergatit ne vitin 1995, por deri me sot nuk eshte pershtatur nga Qeveria e Shqiperise. Megjithete ky ligj eshte perdorur me raste si nje udhezues ne procedurat e VNM ne Shqiperi. Megjithete Ligji Nr. 8990 per Vleresimet e Ndikimeve te Mjedisit u aprovua me 10/02/2003. Ky ligj percakton te gjithë procedurat per pergatitjen dhe paraqitjen per aprovim te VNA ne Shqiperi. Ligji gjithashtu percakton se cfare nivelesh te VNM duhet te ndiqen per lloje te ndryshme zhvillimi.

Nje seri me ligje te tjera jane duke u pergatitur per te mbeshtetur Ligjin Nr. 8934 per Mbrojtjen e Mjedisit i dates 5/09/2002 duke perfshire:

- kontrollin e ndotjes
- mbrojtja e banoreve dhe e biodiversitetit
menaxhimi i mbetjeve
vendosja e masave mjedisore
kerkesat per monitorim

Egzistojne legjislacione te cilat ndikojne ne mjedis sic jane:

Ligji Nr. 7875, dt 23.11.1994 “Mbi mbrojtjen e faunes se eger dhe gjuetine”

Ligji Nr 8093 – amenduar nga ligjet 8375, 8605,dhe 8736, rregullon shfrytezimin e zhavoreve nga shtratet e lumenjve, perrenjve, etj.

Ligji Nr 8561 – Per Shpronosimin dhe Marrjen e Perkohshme per Interesat Publike 12/22/1999 - percakton procedurat per shpronosimin e tokes dhe nivelet e kompensimit per interesa publike.

Ligji Nr. 7623 – Per Pyjet dhe Policine e Pyjeve ne vitin 1992dhe sic eshte amenduar (Nenet 63 & 64) nga Ligji Nr. 7839 – percaktojne shfrytezimin e pyjeve.

Ne raste ekstreme publiku ka te drejte te kerkoje referendume kombetare ose te pjeseshme per ceshtje te vecanta te mjedisit sipas Ligjit Nr. 7866 ne Referendumin te dates 6/10/1994.

Ligji 8561, 22/12/1999, percakton qe personat private kane te drejta ne respekt te pronesise private qe ata disponojne dhe se e drejta e pronesise publike ushtrohet vetem per ineteresa publike dhe nuk mund te realizohet dhe mbrohet ne menyre tjeter. Ai percakton me tej se te drejtat e pronareve jane te mbrojtura dhe se te drejtat e te treteve te pronave te tyre jane zhvleresuar si rezultat i shpronasimit.

Ne rastet e shpronasimeve per ineresa publike nga ana e shtetit, ministri kompetent, ne kete rast Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit) cakton nje komision special qe te administroje ne menyre te pershtateshme shpronasimet dhe te vendose vleren e pronesive per t'u shpronasuar. Vendimet e shpronasimit nga ana e Ministrit i paraqiten KM per vendim dhe pronaret e pronave kane te drejte te apelojne, por apelimi nuk duhet te vonoje shpronasimin.

Ligji Nr.8897, datë 16.5.2002 Ky ligj ka për qëllim të garantojë të drejtën e shtetasve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit shqiptar nga ndotja e ajrit.

Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002 për zonat e mbrojtura, Ky ligj ka për objekt shpalljen, ruajtjen, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe të burimeve natyrore e biologjike të tyre; lehtësimin e kushteve për zhvillimin e turizmit mjedisor; për informimin dhe edukimin e publikut dhe për përfitime ekonomike, të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, nga popullsia vendore, nga sektori publik dhe privat.

Ligji Nr.9010, datë 13.2.2003 për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta Ky ligj synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta, nëpërmjet administrimit mjedisor të tyre në çdo fazë, përfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin, të cilat çojnë në pakësimin e mbetjeve dhe zvogëlimin e ndikimeve të tyre të rrezikshme e të dëmshme.



Kuadri Institucional

Agjensia Kombetare e Mjedisit (AKM) u krijua ne vitin 19981. Ne vitin 2002, ligji i ri percaktoi se Ministria e Mjedisit, e cila duhet te ofroje nje kontroll te centralizuar te mjedisit ne emer te Ministrise se Mjedisit (Neni 67).

Neni 64 percakton qe Ministria e Mjedisit mbeshtetet nga:

- Agjensite Rajonale te Mjedisit (nga te cilat jane 12)
- Muzeun Kombetar te Shkencave Natyrore
- Institutte te Kerkimeve Pyjore, Kullotat dhe Livadhet
- Institueti i Kerkimeve te Peshkimit
- Instituti i Kerkimeve Biologjike
- Ministria e Bujqesise (pergjegjese per kontrollin e pyjeve)

Megjithe kete mori institutesh pergjegjese per monitorimin, aktualisht jane realizuar pak studime ne kete fushe ne gjendjen e flores dhe te faunes ne Shqiperi, qe vjen kryesisht si rezultat i kufizimeve buxhetore.

Institucione te tjera qe kane nje rol te rendesishem ne mjedis jane:

- Ministria e Infrastruktures dhe Transportit
- Ministria e Ekonomise, Sipermarrrjes dhe e Turizmit
- Ministria e Shendetesise dhe Instituti i Shendetit Publik – pergjegjese per monitorimin e cilesise se ujit te pishem dhe cilesise se ajrit
- Instituti Hidro-Meteorologjik– mbledhjen e te dhenave meteorologjike dhe eshte pergjegjese per monitorimin e cilesise se ujit dhe te ajrit
- Ministria e Bujqesisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

Pershkrimi i gjendjes se mjedisit

Gjeologjia

Destinacioni i ketij studimi eshte percaktimi I karakteristikave fiziko mekanike te dherave dhe shkembinjve qe takohen ne zonen ku kalon objekti 1-kt per fazen e projektit te detajuar. Te dhenat e marra nga punimet fushore dhe ato laboratorike do ti sherbejne projektuesve per te realizuar projektin per ndertimin e objektit. Ne kete studim do te percaktohen vendet dhe karakteristikat e materialeve te ndertimit qe jane te nevojshme per ndertimin e ketij objekti 1-kt.

Per te realizuar kete kemi kryer disa lloje testimesh ne terren dhe ne laborator te cilat po i permendim si me poshte:

1. Shpime te cekta dhe gropa ne akset e godines ekzistuese.
2. Prova me pllake ne themelin e godines ekzistuese.
3. Analiza Laboratorike



Gjeomorfologjia

Ne kete kapitull do te shtjellojme pershkrimin e zones ku shtrihet objekti ekzistues ne qytetin Peqin; format e relievit te sotem dhe te hershem, kushtet gjeologjike te formimit te ketij relievi. Do te behet pershkrimi i fenomeneve gjeologjike dhe gjeodinamike te zones.

Vendodhja e objektit dhe pershkrimi i relievit

Vendi ku kalon objekti eshte qyteti Peqin, Bashkia Peqin dhe ka nje sip $5275m^2$. Ky objekt sherben si institucion arsimor(9-vjecare + godine 1kt per kopesht). Zona eshte me reliev fushor.

Peisazhi dhe topografia

Terreni i kesaj zone eshte fushor, si dhe ne rajon gjenden zona te kultivuar me foragjere, peme frutore (veçanerisht vreshta) si dhe me shkurre mesdhetare me nje bimesi mesatare. Pamjet piktoreske te rruges jane ato fushor, i fragmentizuar, me bime dekorative. Peisazhi ne kete zone eshte brenda konturit estetik te zonave rurale ekzistuese. Kjo zone ka nje peisazh te vecant e te pasur me bimesi te shumellojshme. Ne kete siperfaqe ka ndertesa nje, dy dhe tre kateshe ne pronesi te banoreve te zones, por qe jane te vendosura ne distanca te konsiderueshme nga njera tjetra. Siperfaqe e propozuar per shfrytezim ze nje siperfaqe prej $5275m^2$.

Toka

Toka eshte e kafejte me shtrese aktive nga 15cm deri ne 25cm. Rajoni i zones se Peqinit ka siperfaqe qe ka gene ne fondin barishtor e cila eshte perdorur per mbjelljen e kulturave te produkteve te ndryshme bujqesore. Ne kete zone te studimit nuk ka bimesi e cila vleresohet si e rrezikuar apo e kercenuar pasi vleresohet si zone e pasur dhe e shfrytezuar nga banoret e saj. Trualli ku vendoset objekti nuk eshte i pjerret por i sheshte.

Hidrografia

Ne kete rajon takohen shume burime ujore. Niveli i ujit nentokesor eshte 3.8m nga siperfaqja e tokes por ne puset e shpimit ai arrin te ngrihet dhe te stabilizohet ne 0.6-0.8m thellesi dhe ne varesi te stines niveli i tyre ndryshon, por kryesisht prurja eshte konstante dhe e bollshme gjate gjithë periudhes se vitit. Pasqyra e nivelit te perhershem te ujerave nentokesor ka luhajte eshte si pasoje e rreshjeve qe bien ne kete zone gjate stines se vjeshtes dhe dimrit. Ne zonen e shfrytezimit dhe perreth saj nuk ka zona te lundrueshme dhe nuk ndodhen liqene dhe dete, prandaj gjate shfrytezimit nuk do te cenohen rruget ujore, brigjet bregdetare etj. Ne konturin anesor te zones dhe ne pjesen lindore te prones ne studim vihet re ish kanalet e drenazhimit qe kane ekzistuar per keto toka bujqesore.

Klima

Klima në Peqin është e ulët $5^{\circ}C$ në janar dhe e lartë $28^{\circ}C$ në Korrik dhe Gusht. Qershori, Korriku dhe Gushti janë muajt, më të nxehtë dhe më të thatë.

Cilesia e Ajrit dhe Zhurmat

Cilesia e Ajrit

Megjithese nuk ka monitorime per cilesine e ajrit, mund te themi se cilesia e ajrit eshte shume e mire. Burim i

ndotjes se ajrit ketu jane punimet e mundshme te banesave, dhe nga emetimi i gazrave nga makinerite' e transportit te rende, te materialeve te ndryshme inerte si shkak i afersise me shume aktivite bujqesore qe kane ne permbajtje grimca te LNP dhe PM10. Duke pasur parasysh vendodhjen dhe terrenin ndikimi eshte i pa konsiderueshem.

Ndotja akustike

Zhurmat ne kushtet aktuale nuk perbejne ndonje shqetesim. Krijuesit me te medhenj te zhurmave jane mjetet, paisjet motorrike dhe levizese. Matje per nivelin e ketyre zhurmave deri tani nuk jane kryer.

Biodiversiteti

Larmia biologjike paraqitet e pasur dhe perqendrohet kryesisht ne bimesine barishtore, ne shkurre dhe drure te ndryshem. Zona eshte e pasur me gjitareve te vegjel, zvarranike e shpend te llojeve te ndryshem. Por qe nuk paraqesin rrezikshmeri per te ulur biodiversitetin e zones.

Flora dhe fauna

a. Ekosistemet, habitatet Vendndodhja e godines eshte nje shesh me karakteristika qe i ploteson kushtet per kete lloj veprimtarie nje zone e cila po zhvillohet me karakter bujqesor. Per rreth ketij sheshi gjendet nje zone me bimesi te ulet. Ekositemi dhe habitatit me i rendesishem ne kete zone jane bimet barishtore dhe shkurret ku dominancën e kane lloje te shkozës (Carpinus sp.) dhe manafere (Rubus Imifblius). Vleresohet bimesi tipike sipas zonave rurale. Duhet te theksojme se eshte nje zone teresisht bujqesore.

b. Perberja dhe llojet ekzistuese.

Karakteristika te flores.

Terreni ku ndodhet objekti eshte toke me pjerresi rreth Igrade, e varfer ne mbulesë bimore te ulet takohen kryesisht bimet barishtore si gram (Agropyrum sp) Geranium sp. Trifolium Sp.dhe pa ndonje bimesi me rendesi , te vecante apo te rralle per t'u permendur. Vlerat ekonomike dhe ekologjike jane te uleta. Po keshtu te' uleta jane' edhe vlerat potenciale rikrijuese, sociale e turistike. Ndikimi real eshte mbi mbulesen vegjetative ne sheshin e ndertimit, e cila duhet pranuar se nuk demtohet ne' menyre drastike. Por edhe ai ndikim i vogel mbi mjedisin me masat reabilituese pas perfundimit te aktivitetit ky dem eshte i riparueshem

Karakteristikat e faunes.

Ne potencialet faunistike nuk vihet re ndikimi urban, objekti ndodhet ne qytetin Peqin. Nga bisedat me banoret per rreth dhe vezhgimet tona, kjo zone eshte e pasur ne lloje shtazore.

Ndikimet negative mbi faunen eshte i ndryshme mbi lloje te ndryshme. Llojet qe ndikohen me shume jane ato te klases se zvarranikeve.Takohen me dendur lloje te zvarranikeve si hardhuca e mureve (Lacerta muralis), zhapiku (Lacerta viridis), gjarperinjt (Vipera amodytes, Elaphe longissima etj) dhe breshkat (Testudo hermani). Brejtesit nuk kane' perhapje te vecante. Aerofauna paraqitet me popullata te dobesuara e qe me shume bien ne sy shpendet karakteristik te zonave urbane e si harabelat, trumcaket, pellumbat e eger dhe mellenjat. Grabitqaret si falkonjtë jane' kalimtare te rralle. Kjo aerofaune" ndikohet vetem nga zhurmat.



Perdorimi i biodiversitetit.

Elementet qe lidhen me biodiversitetin nuk jane perdorur ne menyre te planifikuar ose per qellime te vecanta nga subjekte te ndryshem, qofte edhe per bime mjeksore.

Trashegimia arkitektonike dhe historike, zonat arkeologjike.

Zona ku ndodhet objekti nuk dallohet per objekte te vecanta arkitekturore e historike si dhe gjetje arkeologjike. Sipas studimit gjeologjik gjeomorfologjike e arkitektonike jane te zakonshme, e deri sot nuk perfaqesojne ndonje objekt te vecante per t'u marre ne mbrojtje ligjore.

Toka bujqesore

Bujqësia e zones mbart në vetvete problemet tipike të sektorit si infrastruktura, sistemi i transportit jo i mjaftueshëm, mungesa e zhvillimit të sektorëve të tjerë që koepërojnë me bujqësinë, mungesa e një tregu të organizuar bujqësor, ferma të copëzuara dhe me madhësi shumë të vogël parcele, niveli i ulët ekonomik i fermerëve dhe mungesa e mbështetjes nga shteti, OJQ-të apo fondacionet me kredi, mungesa e tregut dhe zhvillimi kaotik i tij, mungesa e mekanikës së mjaftueshme dhe tarifave të larta, çmimet e larta të imputeve bujqësore (farna, fidana, plehra dhe medikamente), teknologjia e vjetër agropërpunuese, niveli i ulët i bashkëpunimit të fermerëve midis njëri- tjetrit duke ulur fuqinë negociuese në treg.

Krahas faktorëve negativë, bujqësia e zones bazohet në faktorë pozitivë të cilët lehtësojnë zhvillimin e bujqësisë ndër këto karakteristika si më kryesorët mund të përmendim:

- Niveli i lartë i kulturës profesionale së fermerëve dhe tradita e tyre në miradminstrimin e burimeve natyrore dhe në prodhimin e produkteve tradicionale të zonës;
- Kushtet e përshtatëshme klimatiko- tokësore për një zhvillim optimal blektorisë së imët dhe produkteve të veçanta bujqësore;
- Pyje dhe kullota të cilat mundësojnë zhvillimin e blektorisë;
- Traditë e gjerë në mbarështrimin e blektorisë si produkte të kërkuara gjerësisht nga tregu



Karakteristikat e sektorit blektoral

Blegtoria është sektor me peshë të rëndësishme në zhvillimin ekonomik të zones. Niveli i krerëve është rritur në mënyrë të ndjeshme gjatë dhjetë viteve të fundit. Aktualisht në komunë mbarështohen rreth 1030 krerë gjedhë, nga këto lopë 400 krerë, te imta 10600 krerë, nga të cilat: dhen 4500 krerë, dhi 5100 krerë, njëthundrakë 620 krerë, bletë 200 zgjoje.

Në zone prodhohen rreth 1000 ton qumësht, nga të cialt përpunohet në baxhot e zones rreth 250 ton, ndërsa pjesa tjetër përpunohet në mënyrë artizanale nga ana e vetë fermerët tregtohet në formën e produktit të freskët në tregun e Qytetit apo konsumohen nga familjet fermere. Zhvillimi sasior i kapaciteteve përpunuese por edhe përmirësimi i cilësor i produkteve është një kërkesë imediate e cila mundson ruajtjen e ritmeve aktuale të sektorit.

Mbetet akoma për tu përmirësuar niveli shërbimeve veterinare dhe zooteknike (në përmirësimin racor, strukturën e blektorisë, aplikimin e racioni të balancuar ushqimor, etj.

Analize e elementëve ekonomikë dhe social.

	Zhvillimi ekonomik	Demografia dhe zhvillimi social	Infrastruktura dhe shërbimet
Forcat	Kushte natyrore, për një zhvillim blektoral, të zonës nëpërmjet rritjes së kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese.	Popullsia e re e cila ka një nivel të lartë shkollimi	Investime të pjesëshme të kryera në zonë gjatë viteve të fundit, dinamikë nga ana e komunitetit për rritjen e nivelit të investimeve

<p>Dobësitë</p>	<p>Mungesa e aftësive investuese, si edhe kapaciteteve të cialt mundësojnë investimet</p> <p>Ulje e vazhdueshhme e popullsisë aktive për punë në zonë si pasojë e emigracionit apo eksodit rural</p>	<p>Nivel i lartë eksodi rural veçanërisht në fshatrat malorë boshatisja pothuaj totale e të gjithë këtyrefshatrave</p> <p>Migram i vazhdueshëm sezonal, mungesë integrimi itë rinjve në aktivitete ekonomike në zonë, nivel i ulët ishkolimit të specializuar që ofron profesion.</p>	<p>Mungesa të theksuara në infrastrukturë, rrugore, apo urbane, mundësi të kufizuara për investime apo ndërhyrje meremetuese,</p> <p>Pamundësia për të të rritur aftësinë profesionale të presonelit mjeksor, arsimor etj.</p>
<p>Mundësitë</p>	<p>Rritja e kërkesave nga ana e konsumatorëve për produkte natyrale, autentike, zona natyrore dhe larg sistemeve turistikë të masës</p>	<p>Rritja e nivelit të investimeve infrastrukturore si mundësi për të ulur nivelin e migrimit jashtë zonës.</p>	<p>Rritja e ndihmës nga institucione financuese për zonat malore, rurale, në zhvillimi etj.</p>
<p>Kërcënimet</p>	<p>Hapja e tregut ndaj produkteve me aftësi konkurruese të lartë</p>	<p>Tendenca e përgjithshme e boshatisjes së zonave rurale me qëllim lëvizjen drejt qyteteve me më shumë mundësi ekonomike dhe sociale</p>	<p>Ulje në mënyrë të vazhdueshme e angazhimit shtetëror rreth nivelit të investimeve në këto zona.</p>



Pershkrimi i Masave Lehtesuese

Per te ulur nivelet e ndikimeve negative duhet te identifikohen masat lehtesuese. Masat lehtesuese do te zhvillohen gjate projektit paraprak dhe te detajuar dhe do te zbatohet gjate fazes ndertuese dhe operuese. Do te tregohen masat per ndertimin e kantierëve. Perberesit e masave lehtesuese qe duhet te merren ne konsiderate jane si me poshte:

- Ndotja e Ajrit
- Gerryerja e tokes
- Ujrat Siperfaqesore dhe Tokesore
- Zhurmat
- Flora dhe Fauna
- Pejsazhi dhe Shfrytezimi i Tokes
- Trashegimia kulturore

Masa te Tjera Lehtesuese

Ne programin e Bashkise do te jete forcimi institucional dhe trajnimi i duhur i stafit per te siguruar implementimin ne te ardhmen te masave lehtesuese, menaxhimin e mjedisit dhe planin e rivendosjes se vendbanimeve.

Programi i Lehtesirave

Eshte pergatitur nja program lehtesirash per secilin ndikim mjedisor, i cili perfshin kostot dhe pergjegjesite, Nivelet e ndikimeve duhet te jene shume te ulta dhe nuk jane te nevojshme nderhyrje te kushtueshme. Keto masa duhet te perfshihen ne kontraten e ndertimit.

Rregullimet Institucionale

Kontraktori, nen supervizimin e Bashkise Peqin, do te jete pergjegjes per keto masa. Bashkia do te formoje nje Njese Mjedisore nen drejtimin e Departamentit Teknik. Kjo do te mbeshtetet nga nje konsulent mjedisor, mundesisht nje ekspert i huaj me nje ekperience perkatese te konsiderueshme.

Kontraktoret do te jene gjate gjithë kohes ne zone dhe aktivitetet e tyre do te jene burime te ndikimeve te pafavorshme gjate fazes se ndertimit. Per kete arsye, kontraktoret jane celesi i zbatimit te planit te lehtesirave.

Plani i Monitorimit te Mjedisit

Monitorimi i mjedisit eshte pjese e programit te menaxhimit te mjedisit per fazat projektuese, ndertuese dhe operuese te projektit. Si me poshte jane treguar objektivat e programit te monitorimit te mjedisit.

Monitorimi perpara ndertimit ka qellim te percaktoj fazen fillestare ("situata zero") dhe perdorimin e saj meqenese ajo do te krahasohet me te dhenat e vezhguara gjate dhe pas fazes ndertuese.

Monitorimi gjate fazes se ndertimit duhet te ndjek qellimet e meposhtme:

- Te pershkruaje situaten mjedisore dhe te verifikoje se fenomenet mjedisore jane koherente me parashikimet e studimit te ndikimeve te mjedisit.
- Te identifikojte disa emergjenca te vecanta mjedisore per t'u lehtesuar dhe per te shmangur shmangur veprimet te cilat mund te ndikojne ne cilesine e mjedisit
- Te kontrolloje disa situata specifike ne menyre qe te modifikojte sa me shpejt aktivitetet e punes ne perputhje me kerkesat e mjedisit.

Monitorimi pas punimve ndertuese ka qellimet e meposhteme:

- Te verifikoje ndikimet e mjedisit te shkaktuara nga realizimi i punimeve
- Te verifikoje nese masat lehtesuese jane efikase per mbrojtjen e mjedisit
- Te pershtase masa te tjera lehtesuese per efekte te paparashikuara

Plani i Monitorimit

Programi i monitorimit do te mbuloje cilesine e ajrit, zhurmat, cilesine e ujrave siperfaqesore dhe nentokesore dhe zgjerimin e drejtimet baze, fazat ndertuese dhe operuese.

Struktura e PMM ndjek objektivat e pershtatjes se nje plani elastik dhe ky mund te modifikohet gjate punimeve qe kane si qellim te kenaqin kerkesa te ndryshme, te cilat nuk mund te percaktohen me perpara gjate fazes aktuale, fazes se studimit te fizibilitetit.

Plani Monitorimit percakton nje skeme referuese e lidhur me modalitetet e karakteristikave te perberesve te monitorimit te mjedisit, metodologjive per monitorimin dhe per percaktimin e zones se interesuar nga vete monitorimi.

Projekti, ne menyre te vecante, identifikon perberesit mjedisore te cilet do te analizohen dhe percaktojne vendodhjen e pare te pikes se vezhgimit per te njejtet perberes. Pas perpunimit te projektit, do te jete e mundur te vendosen percaktimet e sakta te pikave te monitorimit.

Si me poshte jane rekomadimet e specifikimeve baze dhe periodike te monitorimit te lidhura me kriteret kryesore te mjedisit:

Cilesia e ajrit

Meqenese disa nga rreziqet e rendesishme te ndikimeve ne cilesine e atmosferes jane perjashtuar gjate fazes se operimit, monitorimi do te merret me ato vende ku fusha e aktivitetit te ndertimit mund te percaktoje disa efekte ndotese nga transporti i materialeve pergjate zbatueshmerise dhe jashte zones.

Zhurma

Sa te realizohet monitorimi i zhurmes ne menyre qe te lehtesohen aktivitetet e meposhteme:

Nje karakterizim i sakte te klimes se akustikes si perpara fazes se ndertimit ashtu dhe gjate periudhes para-operuese, per te gjithe zonen e interesuar te territorit.

Mund te duhet te behet nje kontroll per modifikimin e klimes se akustikes gjate periudhes operuese ne situata ku do te jete e nevojshme sepse gjate kohezgjatjes se ceshtjeve dhe intensitetit ose kushte lokale te vecanta.



Monitorimi mjedisit i lidhur me ndotjen akustike e percaktuar nga infrastruktura, u planifikuan ne lidhje me receptoret prane zonave kryesore te fushes se ndertimit ose zonave urbane.

Ujerat siperfaqesore

Provat qe do te behen per sistemin siperfaqesor hidrologjik, japin mundesine e vleresimit te modifikimit te shkaktuar nga ndertimi i infrastruktures se re si per kushtet e fluksit (dorezimin e ujit, shpejtesia, etj) e cila mund te jete si nje konsekuence e nderhyrjeve fizike, edhe perkohesisht, me rrjedha te tjera uji, ashtu dhe per cilesine e ujit prane kampeve te ndertimit ku mund te kete rezik te lokalizimit te ndotjes.

Ujerat Nentokesore

Vezhgimet per komponentin e interesuar jane planifikuar te kontrollojne kushtet hidro gjeologjike te zones, ku realizimi i punimeve mund te percaktoje disa modifikime kuptimplota te kushteve aktuale. Parametrat qe jane kontrolluar kane qellim te vleresojne si variacionet e kushteve te fluksit ashtu dhe variconet e cilesise se ujrave nentokesore.

Te gjitha aktivitetet mund te percaktojne disa modifikime ne situaten aktuale te shtreterve te gjireve duke krijuar disa bariera ose drenazhe.

Bimesia dhe Fauna

Do te realizohet monitorimi natyral i ekosistemit dhe ne menyre te vecante zonat e pyjeve dhe rrjedhjet e ujrave. Monitorimi do te konsistoje ne vezhgimin e hyrjes te paautorizuar ne zonat e pyjeve (e lehtesuar nga infrastruktura e re) dhe te pritave ilegale. Rezultatet e vezhgimit do t'i paraqiten Bashkise dhe do te shtohen kufizimet e hyrjeve te paautorizuara (barierat, sinjale). Ky ne vazhdimesi eshte nje aspekt shume i rendesishem ne menyre qe te shmange degradimet e shkaktuara nga rruga ne zonat e virgjera.

Per sa i perket faunes, gjate shfrytezimit te rruges do te realizohen monitorime te seksioneve me kritike ku kafshet e egra interferohen me kafshet shtepiake. Ky aktivitet do te konsistoje ne nje vezhgim periodik (vjetor per dy vjete) te aksidenteve me autoritetet e policies lokale. Pas ketij vezhgimi, do te vendosen sinjalistikat treguese te pranise se kafsheve dhe kufizimet ne shpejtesi te levizjes ne seksionet me kritike. Ne qofte se rreziku I aksidenteve eshte I larte, do te pershtaten masa te tjera sic eshte vendosja e disa reflektoreve te vecante pergjate vijejimit te rruges. Keto masa reduktojne frekuencen e kalimit te kafsheve ne rruge.

Standartet e Monitorimit

Ujrat nentokesore

Jane percaktuar tre nivele sigurie per sa i perket cilesise se ujit: kujdes, alarm, nderhyrje

Ne qofte se mesatarja e perqendruar e llogaritur gjate Monitorimit perpara ndertimit, eshte brenda kufijve te parashikuar nga Bashkia 236/1988 dhe modifikimet ne vazhdim, nivelet e kujdesit do te percaktohen ne perputhje me ndryshimet ndermjet vlerave te percaktuara nga ligjet dhe niveli mesatar perpara ndertimit te imfrastruktures.

Nivelet e kujdesit, alarmit dhe nderhyrjes i korrespondojne rritjes se kesaj diference me te larte se 30%, 60% dhe 75%.

Ne rastet kur nivelit e alarmit jane rritur, duhet te kryhen nderhyrjet e meposhteme: Perseritje te menjehershme te provave gjithashtu dhe per gropat dhe piezometrat fqinje.



Kryerja e provave me frekuence mujore dhe percaktimi i karakteristikave baze kimike dhe te atyre karakteristikave qe kane vlera anomalie, duke vazhduar percaktimet tre mujore te te gjitha karakteristikave te tjera;

Individualizimin e shkaktareve te ndotjes;

Verifikimin e efikasitetit te nderhyrjeve te parashikuara per lehtesirat ne ndikimet ne mjedis;

Me rastet kur nivelet e ndrhyrjes jane rritur dhe gjate gjitha periudhes eshte e nevojshme te kemi clerat perseri nen nivelin e kujdesit, duhet te kryhen nderhyrjet e meposhteme:

Perseritje te menjehereshme te provave gjithashtu dhe per gropat dhe piezometrat fqinje;

Realizimin e provave me nje frekuence pesembdhjete ditore dhe percaktimin e karakteristikave kimike baze dhe te atyre karakteristikave te cilat kane vlera anomalie, duke realizuar nderhyrjet eventuale per lehtesimin e ndikimeve.

Verifikimin e efikasitetit te nderhyrjeve te parashikuara per lehtesimin e ndikimeve te gropave ne mjedis;

Individualizimin e shkaktareve te ndotjes;

Pergatitjen e nje plani per permiresimin e dherave dhe per pastrimin e ujrave nentokesore te pakten per seksionet e interesuar nga gropat.

Ne qofte se vlerat e analizave te vlerave te percaktuara gjate MAO kapercejne Kufirin e Lejuar te Perqendrimeve te percaktuar nga ligjet, nivelet jane percaktuar si me poshte:

niveli i kujdesit: kur nje vlere me e madhe se mesatarja plus kur vezhgohet devijimi i stdheartit;

niveli alarmit: kur nje vlere me e larte se mesatarja plus dy here me e larte se vezhgimet e stdheartit te devijuar.;

niveli i nderhyrjes: kur nje vlere me e larte se mesatarja plus dy here devijimet e vezhguara te stdheartit dhe kur perqendrimi i substancave ndotese ne krateret dhe ne piezometrat e vendosur mbi rrjedhe eshte me i ulet se perqendrimi nen rrjedhe.

Per kete situate, ne rast se eshte arritur niveli i kujdesit, eshte e nevojshme te perseriten menjehere provat gjithashtu dhe piesomtrat fqinje.

Ne raste se arrihet niveli i alarmit, duhet te pershtaten nderhyrjet e meposhteme: te perseriten menjehere provat gjithashtu per krateret dhe piezometrat fqinje;

analizat e perqendrimeve per parametrat e interesuar ne krateret dhe piezometrat e vendosur ne sektoret e mbi rrjedhes te planimetrise se hekurudhes.

Ne rastin kur arrihen nivelet e nderhyrjes dhe gjate gjitha periudhes se nevojshme per te pasur vlera me te ulta se vlerat e nivelit te kujdesit, duhet te realizohen nderhyrjet e meposhteme:

te perseriten menjehere provat gjithashtu dhe per krateret dhe piezometrat fqinje; Ajri

Me poshte jane treguar nivelet qe duhet te pershtaten per nivelet e nderhyrjes per substanca te ndryshme ndotese: Keto nivele i korrespondojne niveleve te kujdesit per:



PTS: 150 mg/m³ si mesatare per 24 ore

SO₂ : 125 mg/m³ si mesatare per 24 ore

CO: 15 mg/m³ si mesatare ne nje ore, 10 mg/m³ si mesatare ne 8 ore NO₂: 200 mg/m³ si mesatare ne nje ore.

Keto i korrespondojne niveleve te stdhearteve te cilesise se ajrit: PM₁₀: 40 mg/m³ si mesatare vjetore

SO₂: 80 mg/m³ si mesatare vjetore e mesatares per 24 ore, , 250 g/m³ si 98° perqindesh e mesatares per 24 ore ne vit, 130 g/m³ si mesatare per 24 ore gjate sezonit te dimrit

NO₂: 200 mg/m³ vjen 98° perqindesh e mesatare ne ore ne vit Benzene: 10mg/m³ si mesatare vjetore

Bap: 1 ng/m³ si mesatare vjetore

Ne rastet kur kapercehen nivelet e kujdesit pa asnje shkaktar meterologjik ose si pasoje e aktiviteteve te ndertimit (me shume se 30%), eshte e nevojshme te percaktohen shkaktaret per ndotjen dhe eshte e nevojshme te pershtaten menjehere disa masa lehtesuese. Kapercimi i standarteve te cilesise ne atmosfere te shkaktuara nga aktivitetet e ndertimit ne kantier, percaktojne nevojten e kontrollit te aktiviteteve te ndertimit dhe adaptimin e disa masave lehtesuese.

Zhurma

Kur kapercehen aktivitetet ditore, duhet te pergatitet nje raport jo me vone se tre dite; Pergjegjësia e ndertimit te kantierit duhet te individualizojë metodologjite dhe kohen e nevojshme per te pasur perseri nivele normale te zhurmes. Ne qofte se kapercehen nivelet e nates, duhet te individualizohen shkaktaret dhe duhet te adaptohen disa masa lehtesuese; gjate kesaj periudhe te gjithë aktivitetet qe shkaktojne kapercim te ketyre niveleve duhet te ndalohen. Pas proves akustike, te gjithë aktivitetet e punimeve do te fillojne perseri.


Raportimi

Rezultatet e programit te monitorimit do te perfshihen ne raporte formale me shkrim dhe do t'i paraqiten per rishikim Bashkise, Do te kerkohet nga kontraktori dhe kompanite e mbikqyrjes se ndertimit te raportojne masat ditore te tyre per performimin e mjedisit ne baze mujore. Atyre do t'u kerkohet me tej te raportojne menjehere ndotje ose ndikime te menjehershme te papritura te mjedisit, keshtu qe DPRR dhe/ose kontraktori te marrin masat lehtesuese te nevojshme.

Menaxhimi i Kontraktorit

Kontraktori do te jete ne kantier gjate gjithë kohes dhe aktiviteti i tij do te jete burimi i pafavorshem i ndikimeve gjate fazes ndertuese. Per kete arsye, kontraktori do te jete celesi ne planin e menaxhimit te lehtesirave per mjedisin dhe si i tille, menaxhimi i mjedisit per kontraktorin do te jete kritik per lehtesira te sukseshme. Shih permbledhjen si me poshte.

Figura 5 Organizimi i Menaxhimit te Mjedisit



**STUDIO E PROJEKTIMIT
"A.SH. Engineerig" SHPK**